



Prishtinë, 16 prill 2019
Kodi i ZRRE-së: V_1136_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Neni 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Neni 25, Neni 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Neni 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, Neni 47 dhe Neni 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 16 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e Rregullës për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (Rregulla për Të Hyrat e OSSH-së);
- Parimet për përcaktimin e tarifave për shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes(OSSH) dhe taksave të kyçje;
- Metodologjinë për Përcaktimin e Tarifave të Operatorit të Sistemit;
- Vendimin V_1126_2019 të datës 28 mars 2019 për të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) për OSSH;
- Kërkesën/aplikacionin e KEDS-it për miratimin e tarifave të rregulluara të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, të dorëzuar më datë 08 prill 2019,

në seancën e mbajtur më 16 prill 2019 nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHEN** - tarifat për shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH/KEDS) për periudhën 01 prill 2019-31 mars 2020.
- II.** Struktura e tarifave për OSSH, e cila do të zbatohet nga data 01 prill 2019 është dhënë në tabelën e mëposhtme të këtij Vendimi:

Tarifat e konsumatorëve të kyçur në OSSH		
Niveli i tensionit	Njësia	Tarifa
35 kV	€c/kWh	1.71
10 kV	€c/kWh	2.01
0.4 kV	€c/kWh	2.77

ARSYETIM


- ✚ ZRRE më datën 08 prill 2019 nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH/KEDS) ka pranuar aplikacionin për tarifën e OSSH-së.
 - ✚ ZRRE për vendosjen e tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH/KEDS), ka marrë parasysh dokumentet e përgatitura, lëshuara dhe të publikuara në faqen zyrtare të ZRRE-së, si në vijim:
 - Raportin Konsultativ - Përshtatjet vjetore të Të Hyrave të Lejuara Maksimale për OSSH/KEDS (prill 2019 - mars 2020), i publikuar në muajin shkurt 2019; dhe
 - Raportin përfundimtar për Të Hyrat e Lejuara Maksimale të OSSH-së, dhe përgjigjet ndaj Komenteve (prill 2019 - mars 2020), i publikuar në muajin prill 2019.
 - Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante dhe pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga palët, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, do të zbatohet nga KEDS SH.A., duke filluar nga data 01 prill 2019 deri në shqyrtimin e rregullt tarifor.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit.

Vendimi iu dërgohet:

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (KEDS),dhe
Arkivit të ZRRE-së

Bordi i Rregullatorit:


Arsim Jahova, u.d Kryesues


Besim Selifaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar